

VENDIM
Nr. 36, datë 28.1.2000

PËR KRIJIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR SHQIPTAR PËR UNESCO-N

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 3, të ligjit nr.8371, datë 9. 7. 1998, “Për lidhjen e traktateteve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Komisionit Kombëtar Shqiptar për UNESCO-n, që më poshtë do të mbahet emërtimi “Komisioni Kombëtar”.

Komisioni Kombëtar është një organizëm, që bashkëpunon ngushtë me Ministrinë e Punëve të Jashtme, me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës dhe me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Kryetari i këtij komisioni është ministri i Arsimit dhe Shkencës.

2. Funksionet e Komisionit Kombëtar janë si vijon:

a) Këshillon qeverinë në të gjitha fushat që mbulon UNESCO-ja, sipas programeve të saj.

b) Shërben si koordinator ndërmjet UNESCO-s dhe departamenteve ministrore, instituteve, organizatave dhe individëve, që janë të interesuar për përparimin e arsimit, shkencës, kulturës dhe të informacionit në Republikën e Shqipërisë.

c) Siguron pjesëmarrjen aktive të Republikës së Shqipërisë në përgatitjen, planifikimin, ekzekutimin dhe vlerësimin e programeve e veprimtarive të UNESCO-s.

ç) Bën të njohura objektivat dhe qëllimet e UNESCO-s, nëpërmjet angazhimit të qarqeve intelektuale dhe shkencore, në procesin e përgatitjes dhe të zbatimit të programeve të UNESCO-s, duke i dhënë përparësi përhapjes ose informacioneve për to.

d) Ndhmon qeverinë në përgatitjet për pjesëmarrjen në sesionet e Konferencës së Përgjithshme dhe të mbledhjeve të tjera ndërqeveritare, të organizuara nga UNESCO-ja.

dh) Nxit dhe zhvillon marrëdhëniet me komisionet e tjera kombëtare për UNESCO-n, në mënyrë të veçantë me ato në rajon, dhe merr pjesë, së bashku me to, në programet e përbashkëta dhe në studimet në interes të Republikës së Shqipërisë.

e) Kryen dhe funksione të tjera, që i ngarkohen nga qeveria.

3. Komisioni Kombëtar përbëhet nga, të shumtën, 30 anëtarë. Anëtarët e Komisionit Kombëtar propozohen e caktohen, me shumicë votash, nga ministri i Punëve të Jashtme, ministri i Arsimit dhe Shkencës dhe ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, për një periudhë deri në 4 vjet, me të drejtë ricaktimi vetëm një herë.

Përbërja e Komisionit Kombëtar është si vijon:

a) Dhjetë anëtarë, përfaqësues të organizmave dhe institucioneve arsimore e shkencore të vendit.

b) Pesë anëtarë, përfaqësues të organizmave dhe institucioneve kulturore të vendit.

c) Tre anëtarë, përfaqësues të medias, gazetarë, e të tjerë.

ç) Katër anëtarë, përfaqësues të organizatave kombëtare joqeveritare, që veprojnë në fushat e veprimtarisë të UNESCO-s.

d) Jo më shumë se katër anëtarë, individë të shquar, personalitete të arsimit, shkencës, kulturës dhe medias.

dh) I deleguari i përhershëm pranë selisë qendrore të UNESCO-s në Paris dhe sekretari i përgjithshëm janë, gjithashtu, anëtarë të Komisionit Kombëtar.

ORGANET E KOMISIONIT KOMBËTAR

A. Asambleja e Përgjithshme

4. Asambleja e Përgjithshme e Komisionit Kombëtar përbëhet nga të gjithë anëtarët e këtij komisioni. Ajo kryesohet nga kryetari i Komisionit Kombëtar. Sekretari i përgjithshëm i këtij komisioni vepron me cilësinë e sekretarit të Asamblesë së Përgjithshme.

Asambleja e Përgjithshme mbledhet të paktën një herë në vit dhe çdo herë tjetër sipas kërkesës

së kryetarit të Komisionit Kombëtar, ose prej shumicës së anëtarëve të saj ose sipas kërkesës së komitetit ekzekutiv, me miratimin e kryetarit të Komisionit Kombëtar.

5. Asambleja e Përgjithshme ka këto funksione:

a) Miraton raportin e Komisionit Kombëtar dhe të organeve të lidhura me të, si dhe jep rekomandime dhe merr masa për zhvillimin e mëtejshëm të programeve dhe veprimtarive të këtij komisioni.

b) Këshillon qeverinë për zgjedhjen e delegacionit për në Konferencën e Përgjithshme të UNESCO-s.

c) I jep rekomandime kryetarit të Komisionit Kombëtar për zgjedhjen e kryetarit dhe anëtarëve të komitetit ekzekutiv dhe të kryetarëve të nënkomiteteve, ose të komiteteve ad-hoc.

ç) Nxit lidhjen e ngushtë dhe bashkëpunimin ndërmjet Komisionit Kombëtar dhe departamenteve ministrore, agjencive, shoqatave profesionale, organizatave joqeveritare, universiteteve dhe qendrave të tjera të kërkimeve shkencore dhe të institucioneve të ndryshme arsimore, shkencore, teknologjike, kulturore dhe të informacionit.

B. Komiteti ekzekutiv.

6. Komiteti ekzekutiv i Komisionit Kombëtar përbëhet nga kryetarët e komiteteve të specializuara dhe kryesohet nga kryetari i Komisionit Kombëtar. Sekretari i Përgjithshëm i këtij komisioni vepron si sekretar i komitetit ekzekutiv.

Komiteti ekzekutiv mblidhet nga kryetari i tij sa herë është e nevojshme.

7. Komiteti ekzekutiv ka këto funksione:

a) Merr vendime për zbatimin e e programeve të Komisionit Kombëtar në periudhën ndërmjet sesioneve të Asamblesë së Përgjithshme.

b) Këshillon qeverinë për kontributet e saj për planifikimin, ekzekutimin ose vlerësimin e programeve të veprimtarive kombëtare, rajonale, ndërkombëtare të UNESCO-s.

c) Jep këshilla për ndjekjen e veprimeve të rekomanduara nga konferencat e UNESCO-s, nga departamentet e organet qeveritare.

ç) Siguron mbikëqyrjen e zbatimit të vendimeve dhe të rekomandimeve të Asamblesë së Përgjithshme dhe harton raporte për to.

C. Komitetet e specializuara.

8. Komitetet e specializuara përbëhen nga anëtarët e Asamblesë së Përgjithshme. Ndarja nëpër komitete e anëtarëve të Asamblesë së Përgjithshme bëhet nga kryetari i Komisionit Kombëtar.

Kryetarët e komiteteve zgjidhen me shumicë të thjeshtë votash nga anëtarët e komitetit, në mbledhjen e parë të komiteteve. Anëtarët zgjidhen nga radhët e ekspertëve kombëtarë të fushave të arsimit, shkencës, kulturës dhe informacionit. Komitetet mblidhen sa herë që është e nevojshme.

9. Komitetet e specializuara kanë këto funksione:

a) I japin mendime këshillimore Komisionit Kombëtar dhe organeve të lidhura me të për çështjet brenda përgjegjësisë të tyre.

b) Përgatisin raporte, dokumente dhe studime për programet e UNESCO-s, për konferencat e takimet e organizuara nga UNESCO-ja, si dhe për kontributin e organeve shterërore për sa më sipër.

c) Japin rekomandime, sipas kërkesave, për përgatitjen, zbatimin dhe vlerësimin e projekteve kombëtare për çështjet brenda përgjegjësisë të tyre.

10. Krijohen shtatë komitete që do të mbulojnë këto fusha:

a) Arsimi (përfshirë arsimin e lartë);

b) Shkencat natyrore dhe teknologjia;

c) Kultura dhe artet;

ç) Shkencat shoqërore dhe humane;

d) Informacioni dhe komunikimi;

dh) Gruaja dhe zhvillimi;

e) Rinia dhe sportet;

Ç. Komitetet ad-hoc.

11. Për realizimin e detyrave të caktuara prej tij, komiteti ekzekutiv mund të krijojë komitetet ad-hoc. Qënia e tyre varet nga periudha e zgjatjes së veprimtarisë për të cilën ata u krijuan.

D. Sekretariati i përhershëm i Komisionit Kombëtar.

12. Komisioni Kombëtar ka një sekretariat të përhershëm, i cili vepron pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme, si një sektor në varësi të Drejtorisë që mbulon OKB-në dhe agjencitë e

specializuara të saj. Në krye të sekretariatit të përhershëm është sekretari i përgjithshëm i Komisionit Kombëtar, i cili ka funksionin e shefit të këtij sektori.

13. Sekretariati i përhershëm ka këto funksione:

a) Përgatit, në këshillim me komitetin ekzekutiv, projektprogramin vjetor të Komisionit Kombëtar.

b) Bashkërendon veprimtarinë e Komisionit Kombëtar, si dhe përgatit raportin vjetor për këtë veprimtari;

c) Siguron bashkërendimin dhe këshillimin ndërmjet Komisionit Kombëtar dhe institucioneve dhe agjencive, qeveritare dhe jo qeveritare.

ç) Harmonizon bashkëpunimin ndërmjet komiteve të specializuara;

d) Nxiti studimet dhe projektet në arsim, shkencë, kulturë e informacion, në bashkëpunim me komitetet e specializuara.

dh) Ndjek dhe siguron ekzekutimin sistematik të programeve të UNESCO-s, regjistrimin dhe arkivimin e tyre.

e) Mban lidhje me sekretariatit të UNESCO-s në Paris dhe me komisionet e tjera kombëtare, të rajonit e më gjerë.

ë) Mban lidhje të rregullta me delegacionin e përhershëm të Republikës së Shqipërisë në UNESCO, Paris.

f) Organizon, në bashkëpunim me organizmat e tjera qeveritare ose joqeveritare, mbledhje të UNESCO-s për çështje me interes të përbashkët.

g) Përgatit planin e punës për mbledhjet e Komisionit Kombëtar.

Në mbështetje të funksioneve që parashikon ky vendim dhe të realizimit të korrespondencës me institucionet brenda dhe jashtë vendit, dokumentet e sekretariatit të përhershëm të Komisionit Kombëtar nënshkruhen vetëm nga sekretari i përgjithshëm, me miratimin paraprak të drejtorit të drejtorisë nga e cila ai varet.

Dh. Mjetet dhe burimet financiare.

14. Veprimtaria e Komisionit Kombëtar financohet dhe sponsorizohet nga subjekte e donatorë të ndryshëm, në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

15. Ministria e Punëve të Jashtme siguron personelin dhe fondet për mbarëvajtjen e punës për sekretariatit të përhershëm të Komisionit Kombëtar, si dhe mund të financojë pjesëmarrjen e anëtarëve të Komisionit Kombëtar në veprimtari të ndryshme jashtë vendit.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Ilir Meta